

VENDIM
Nr.399, datë 21.6.2006

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet, e plota dhe të pjesshme, të pleqërisë, pensionet e parakohshme të pleqërisë, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetërsi shërbimi, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rriten në masën 5 për qind.

2. Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rriten në masën 5 për qind.

3. Pensionet e posaçme shtetërore dhe shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rriten në masën 5 për qind.

4. Pensionet, e plota dhe të pjesshme, të pleqërisë, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rriten në masën 20 për qind.

5. Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të rriten në masën 20 për qind.

6. Rritje pensioni përfitojnë:

a) Pensionet e përmendura në pikat 1, 2 e 3 të këtij vendimi, të cilat caktohen duke filluar nga data 1.7.2006, me kusht, që data e fillimit të pensionit të jetë deri më datën 30.6.2006, përfshirë edhe këtë datë.

b) Pensionet e përmendura në pikat 4 e 5 të këtij vendimi, të cilat caktohen duke filluar nga data 1.7.2006, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më datën 30.6.2006, përfshirë edhe këtë datë.

7. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, që caktohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar pensionet që caktohen në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të këtij ligji, me datë fillimi nga data 1.7.2006 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 8 240 (tetë mijë e dyqind e dyzet) lekë në muaj dhe jo më shumë se 16 480 (gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë në muaj.

8. Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, që caktohen sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi nga data 1.7.2006 e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 4 110 (katër mijë e njëqind e dhjetë) lekë në muaj.

9. Rritja e pensioneve, të parashikuara nga ky vendim, të zbatohet edhe për shtesat mbi

pension, të dhëna sipas neneve 33, 38 e 39, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.

10. Pensionet e caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994 të Presidentit “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”, miratuar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994, rriten në masën 5 për qind.

11. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, për vitin 2006, në shumën 1 470 milionë lekë, të përballohen nga:

- Fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

927 milionë lekë.

- Fondi i kontigjencës, i caktuar në pikën 1/3 të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006”

543 milionë lekë.

12. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha